Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Gjemajli Bellanica	**20.10.2023**	**25.10.2023**	**2023/0789**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 12.10.2023, OE "MEDPLUS SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0789, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "MEDEKOS SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material shpenzues sanitar dhe barna per nevojat e QKMF-se-Prizren" me nr. të prokurimit: "622-23-5623-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: Lot 1, 120 000.00 €.

Ankesa është e pësëritur si dhe lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/617 i dt:20.09.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Njoftimi për kontratë 01.06.2023.

Hapja e Ofertave 12.07.2023.

Njoftimi mbi vendimin e AK-së 02.10.2023.

Kërkesa për rishqyrtim 06.10.2023.

Vendimi ndaj kërkesës për rishqyrtim 09.10.2023.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 61 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 41 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Me dt. 02.10.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë OE **MADEKOS SH.P.K.,** ndërsa neve na është dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si në vijim:

Gjatë llogaritjes sipas formulës ligjore në bazë të çmimeve të dhana nga operatorët

ekonomik na del se OE i rekomanduar nga AK për kontratë MEDPLUS me çmimin prej 5.97 sipas çmimit të peshuar euro ka ofertuar me çmimin JO NORMALISHT TË ULËT dhe si i tillë është i pa përgjeshëm.

Komisioni Vlerësues duke u bazuar Ekpsertizën e ekspertit të OSHP-së edhe në vendimin e P.SH. me nr.2023/0617 ka ba Ri-vlerësimin e ofertave duke llogaritur cmimin sipas çmimit jo normalisht të ulët dhe nxjerr fitues OE MADEKOS me cmin prej 6.85 euro sipas çmimit të peshuar.

Fillimisht, ne ishim rekomanduar për kontratë në vlerësimin e parë dhe autoriteti kontraktues nuk ka vërejtur asnjë pozicion që oferta jonë ka çmim jo normalisht të ulët dhe nuk janë kërkuar sqarime.
Pas rekomandimit për kontratë, OE Madekos kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim dhe më pastaj ankesë në OSHP.
Pas ankesës në OSHP të OE MADEKOS (tani OE i rekomanduar për kontratë) OSHP-ja ka lëshuar vendimin me **Nr. 2023/0617 të dt.20.09.2023** ku kanë sqaruar dhe konstatuar se palët janë pajtuar me ekspertizën, ndërsa eksperti kishte konstatuar se nuk janë zbatuar procedurat sipas nenit 61 të LPP-së dhe procedura inter partes.
Autoriteti kontraktues me dt.21.09.2023 ka kërkuar sqarime nga ne, ndërsa ne me dt.25.09.2023 jemi përgjigjur duke sqaruar çmimet e ofruara nga ne, madje duke bashkangjitur fatura dhe profatura në të cilat ishim bazuar në momentin e ofertimit.
Bashkangjitur keni këto fatura dhe profatura edhe me ankesë.

Ne jemi eliminuar me arsyetimin se kemi ofruar çmim jo normalisht të ulët duke u bazuar në formulën sipas tabelës për përllogaritjen e çmimeve jo normalisht të ulëta.

Rregullorja Nr.01/2022 për Prokurim Publik e përcakton si në vijim:
41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme :
i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

41.5 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 të LPP dhe paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një tender i tille nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktoj tenderin veçanërisht të ulët.

41.5 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 të LPP dhe paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një tender i tille nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktoj tenderin veçanërisht të ulët.

41.8 Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulet, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:
a. ekonominë e procesit të prodhimtarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
b. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
c. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose
d. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Sipas nenit 41.3 të rregullores së lartpërmendur kur të përmbushen të tri kushtet e përcaktuar në këtë dispozitë atëherë kërkohen sqarime.

Autoriteti kontraktues nuk e ka dëshmuar se janë përmbushur të tri kushtet me rastin e kërkesës për sqarime.
Pavarësisht këtij fakti, edhe nëse janë plotësuar të tri kushtet, duhet të kërkohen sqarime dhe të zbatohet procedura inter partes. Sqarimet janë kërkuar nga ana e AK-së, mirëpo me rastin e eliminimit është cekur se kemi ofruar çmime jo normalisht të ulëta sipas formulës ligjore.
Kur kërkohen sqarime dhe kur ofrohen sqarimet atëherë ose duhet të merren parasysh sqarimet ose nëse nuk merren parasysh atëherë duhet të jepen arsyetime konkrete.

Ne kemi ofruar sqarime në detaje në lidhje me çmimet e ofruara nga ne dhe e kemi dëshmuar me dokumente konkrete se mund ta përfundojmë këtë kontratë, madje kemi shpreh gatishmërinë që të pranojmë edhe rritjen e sigurimit të ekzekutimit nëse e sheh të arsyeshme AK-së për të garantuar implementimin e kësaj kontrate.

Duke pasur parasysh të gjitha sqarimet që i kemi dhënë me shkrim, dëshmitë tjera ku kemi dëshmuar se nuk kemi çmime jo normalisht të ulëta si dhe gatishmërinë tonë që të pranojmë rritjen e sigurimit të ekzekutimit, atëherë kuptohet qartë se ne nuk kemi ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta dhe këtë e kemi argumentuar, prandaj arsyeja e eliminimit është paqëndrueshme dhe e pa bazuar.
Autoriteti kontraktues kur e ka kuptuar se ne i kemi arsyetuar çmimet e ofertës tonë, atëherë ka bërë një kthim mbrapa në procedurë ku pa sqarimeve të kërkuara dhe të pranuara është kthyer tek tabela duke u arsyetuar se kemi ofruar çmime jo normalisht të ulëta sipas tabelës ligjore.
Nga ky veprim i AK-së kuptohet qartë se AK-ja në mënyrë implicite i ka pranuar arsyetimet tona dhe nuk ka mundur të na eliminojë për këtë pikë por është kthyer tek tabela e çmimeve.

Me dt.09.10.2023 kemi pranuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim pa asnjë arsyetim konkret përse është refuzuar kërkesa për rishqyrtim.
Autoriteti kontraktues me këtë rast nuk ka respektuar nenin 108/A të LPP-së sepse vendimi duhet të arsyetohet.
Pra ne nuk kemi pranuar asnjë përgjigje në lidhje me pretendimet tona ankimore dhe dëshmitë e ofruara se ne nuk kemi ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta.
Autoriteti kontraktues vetëm e ka përsëritur arsyen e eliminimit dhe asgjë më shumë dhe kjo ka ndodh për shkak se nuk ka argumente për të arsyetuar vendimin e tyre të kundërligjshëm.

Mbi këtë bazë, sqarojmë se nuk është respektuar neni 61 i LPP-së, sepse nuk është vlerësuar dhe trajtuar drejtë tenderi ynë, konkretisht nuk është vepruar sipas paragrafit 3 të këtij neni pasi që ne kemi ofruar dëshmi dhe shpjegime të mjaftueshme për çmimet e ofruara nga ne.

Duke u bazuar në te gjitha dëshmitë dhe faktet qe u ceken më lartë, konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së, sepse ne jemi eliminuar pa të drejtë edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më te ulët, sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse ne jemi operator ekonomik i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.
Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, ndërsa neve jemi diskriminuar duke u eliminuar pa

të drejtë në këtë aktivitet të prokurimit.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së, e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **MEDPLUS SH.P.K.**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në
RIVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

KRITERET PËR VLERËSIM

Përshtatshmëria profesionale	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo Regjistrin e ndermarjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2.Regjistrimi i TVSH Kërkesa 3.Regjistrimi i Numrit Fiskal Kërkesa 4. Liqencë valide nga AKPM si qarkullues me shumicë për pajisje medicinale (me validitet).	**Evidenca 1 Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje). Evidenca 2 Certifikata e TVSH-kopje. Evidenca 3 Certifikata e numrit fiskal Evidenca 4. Te dëshmohet se OE është i regjistruar ne AKPM si qarkullues me shumice për pajisje medicinale (me validitet)-Kopje**

Kapaciteti ekonomik dhe financiar **Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjat tri viteve të shkuara 2020,2021,2022 ka qen prej jo më pak se Lot I 240.000.00 € Lot II 100,000.00 € Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartësi duhet të plotësojë minimum 60 % lërkesave ekonomiko financiare.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Evidenca 1 Pasqyrat e qarkullim të kompanisë, të shoqëruar me financiar nga banka për tri vite 2020,2021,2022 apo deklaratat vjetore të dorzuara në Administra të Kosovës.**
Kapaciteti teknik dhe professional **Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat etyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se Lot I 180.000,00 € Lot II 75.000,00 € Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të plotësojë minimum 60 % të kapacitetit teknik dhe profesionale të referencave të natyrës së kontratës.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1 Lista e projekteve kontratës e vërtetuar për tri vite OE- (e skenuar nga origjinal elektronike, , të deshmuara me cilat dëshmojnë vlerën e furnizim tyre apo proces verbal përfundimtar të furnizimeve.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni Vlerësues i AK duke u bazuar në ekpsertizën e ekspertit të OSHP-së edl me nr.2023/0617 ka bë Ri-vlerësimin e ofertave duke llogaritur* çmimin e dhan n ligjore *çmimit jo normalisht të ulët.

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

***KOMUNA E PRIZRENIT* shpërblen me kontratë:**

Lot I: MADEKOS SH.P.K., Vragoli (Magjistralja Prishtinë-Pejë), 12000, Fusl çmimin prej: 6.85 euro,sipas çmimit të peshuar

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues kualifikohet si pale me interes sipas nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi nr. 617/23, dt.20.09.2023

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **MEDPLUS SH.P.K.**

Sqarim hyrës,

Aktiviteti i prokurimit me titull "Furnizim me material shpenzues sanitar dhe barna per nevojat e QKMF-se-Prizren" me nr te prokurimit "622-23-5623-1-1-1", paraqitet per here te dytë në OSHP. OE ankues i tanishëm "MEDPLUS shpk" ka qene i rekomanduar per kontratë herën e parë dhe tani është ankues, ndërsa i rekomanduar për kontratë është OE "MADEKOS Sh.p.k".

Në ekspertizën 617/2023 të datës 05.09.2023, në rekomandimin përfundimtar të lëndës kam theksuar se aprovohet ankesa e OE ankues ("MADEKOS") dhe lënda te kthehet në rivlerësim. Autoriteti Kontraktues dhe OE ankues janë pajtuar me rekomandimin dhe Paneli shqyrtues ka nxjerr vendim për pajtim të palëve, vendimi nr.617/2023 i dt. 20.09.2023.

Pretendimi ankimor i OE ankues 1

Përmbledhje e pretendimit ankimor 1

OE ankues thekson se: Ne jemi eliminuar me arsyetimin se kemi ofruar çmim jo normalisht të ulët duke u bazuar në formulën sipas tabelës për për llogaritjen e çmimeve jo normalisht të ulëta.

Sipas nenit 41.3 të rregullores së lartpërmendur kur të përmbushen të tri kushtet e përcaktuar në këtë dispozitë atëherë kërkohen sqarime.

Autoriteti kontraktues nuk e ka dëshmuar se janë përmbushur të tri kushtet me rastin e kërkesës për sqarime. Pavarësisht këtij fakti, edhe nëse janë plotësuar të tri kushtet, duhet të kërkohen sqarime dhe të zbatohet procedura inter partes. Sqarimet janë kërkuar nga ana e AK-së, mirëpo me rastin e eliminimit është cekur se kemi ofruar çmime jo normalisht të ulëta sipas formulës ligjore. Kur kërkohen sqarime dhe kur ofrohen sqarimet atëherë ose duhet të merren parasysh sqarimet ose nëse nuk merren parasysh atëherë duhet të jepen arsyetime konkrete. Ne kemi ofruar sqarime në detaje në lidhje me çmimet e ofruara nga ne dhe e kemi dëshmuar me dokumente konkrete se mund ta përfundojmë këtë kontratë, madje kemi shpreh gatishmërinë që të pranojmë edhe rritjen e sigurimit të ekzekutimit nëse e sheh të arsyeshme AK-së për të garantuar implementimin e kësaj kontrate. Duke pasur parasysh të gjitha sqarimet që i kemi dhënë me shkrim, dëshmitë tjera ku kemi dëshmuar se nuk kemi çmime jo normalisht të ulëta si dhe gatishmërinë tonë që të pranojmë rritjen e sigurimit të ekzekutimit, atëherë kuptohet qartë se ne nuk kemi ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta dhe këtë e kemi argumentuar, prandaj arsyeja e eliminimit është paqëndrueshme dhe e pa bazuar. Autoriteti kontraktues kur e ka kuptuar se ne i kemi arsyetuar çmimet e ofertës tonë, atëherë ka bërë një kthim mbrapa në procedurë ku pa sqarimeve të kërkuara dhe të pranuara është kthyer tek tabela duke u arsyetuar se kemi ofruar çmime jo normalisht të ulëta sipas tabelës ligjore. Nga ky veprim i AK-së kuptohet qartë se AK-ja në mënyrë implicite i ka pranuar arsyetimet tona dhe nuk ka mundur të na eliminojë për këtë pikë por është kthyer tek tabela e çmimeve.

Përgjigjje në Pretendimin Ankimor 1

Eksperti Shqyrtues, sqaron se OE ankues "MEDPLUS Sh.p.k", i ka plotësuar të tre kushtet sipas nenit 41 paragrafi 3 i rregullores për prokurim publik që AK të kërkojë sqarime dhe meqë AK në herën e kaluar nuk ka respektuar Nenin 61 të LPP-së dhe Nenin 41 të rregullores për prokurim publik, andaj kam kërkuar që: citat nga ekspertiza nr.617/23 "*në rivlerësim të AP, AK-ja të ndjek procedurën inter partes dhe të veproj në harmoni me Nenin 41 paragrafi 6 i Rregullores për prokurim Publik Nr. 001/2022, si dhe të konstatoj nëse çmimet e ofruara janë sipas çmimeve të tregut*", mbyll citatin.

Në rivlerësimin e Aktivitetit të Prokurimit, Autoriteti Kontraktues me datë 21.09.2023 ka kërkuar sqarime nga OE "MEDPLUS sh.p.k", ndërsa me datë 25.09.2023 OE "MEDPLUS Sh.p.k" i është përgjigjur AK-së duke i arsyetuar çmimet e ofruara si dhe duke i bashkangjitur dëshmi dokumentare si Faturë dhe pro faturë për çmimet e pretenduara si jo normalisht të ulëta nga ana e AK-së.

Eksperti Shqyrtues, sqaron se AK-ja nuk ka marrë për bazë dëshmitë e ofruara nga OE ankues, por vetëm është thirrur në ekspertizën e eksperti shqyrtues nr.617/23 dt.05.09.2023, dhe pikërisht në këtë ekspertizë është rekomanduar AK që të konstatoj nëse çmimet e ofruara janë sipas çmimeve të tregut dhe AK nuk ka ofruar ndonjë dëshmi që i ka konstatuar çmimet e tilla.

Eksperti Shqyrtues, është mbështetur në paragrafin 2 të nenit 40 të rregullores për prokurim publik ku ndër të tjera theksohet se: Citat "..... *Një vendim për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar" mbyll citatin*. Andaj rekomandimet e ekspertit shqyrtues ne ekspertizën nr. 617/2023 dt. 05.09.2023 nuk kanë nënkuptuar detyrimisht ndryshim të gjendjes fillestare, por është rekomanduar që të zbatohet në tersi dispozita e nenit 61 të LPP-së si dhe neni 41 i rregullores për prokurim publik, dhe aq më tepër kur janë ofruar dëshmi si Fatura dhe pro fatura si dhe pas sqarimeve AK është dashur të ketë në konsideratë dëshmitë e ofruara.

Andaj, eksperti shqyrtues e sheh pretendimin e OE ankues si të bazuar për faktin se dëshmitë e ofruara si Fatura dhe pro fatura, janë dokumente të cilat vërtetojnë se produket (pozicionet) e kontestuara nga OE i rekomanduar për kontratë që herën e kaluar ishte OE ankues, mund të ofrohen me çmime të cilat OE ankues ka ofertuar në këtë AP, dhe AK për çështje eventuale të sigurisë ka mundur të kërkojë rritjen e Sigurisë së Ekzekutimit pasi ka ndjekur fillimisht procedurën "Inter Partes".

Ndërsa në lidhje me mosrespektimin e 108/A ku OE ankues pretendon se AK nuk i ka dhënë përgjigjje në vendimin e kërkesës për rishqyrtim, dhe ka refuzuar si tërsi, eksperti shqyrtues sqaron se paragrafi 9 i nenit 108/A i LPP-së e obligon AK që refuzimin ta arsyetoj, dhe në rastin konkret AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar duke u thirrur në : "*Komisioni Vlerësues i AK duke u bazuar në ekpsertizën e ekspertit të OSHP-së edhe në vendimin e P.SH. me nr.2023/0617 ka bë Ri-vlerësimin e ofertave duke llogaritur çmimin e dhan nga OE sipas formulës ligjore çmimit jo normalisht të ulët.*

Gjatë llogaritjes sipas formulës ligjore në bazë të çmimeve të dhana nga operatorët ekonomik na del se OE i rekomanduar nga AK për kontratë MEDPLUS me çmimin prej 5.97 sipas cmmit të peshuar euro ka ofertuar me çmimin JO NORMALISHT TË ULËT dhe si i tillë është i pa përgjeshëm.

Andaj, eksperti shqyrtues rekomandon që në rivlersim të Aktivitetit të Prokurimit, AK-ja të respektoj në tërsi dispozitat e LPP-së si dhe të ketë parasysh nenin 1, 7 dhe nenin 60 të LPP-së.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa per Lot 1 e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **MEDPLUS SH.P.K.**

Gjemajli Bellanica

Gj. Bellanica